

VENDIM
Nr.494, datë 17.7.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR
“RADIO +3”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të nenit 113 pika c të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr. 045/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë shoqërinë “Radio +3” sh.p.k. për “Radio +3”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 23.09.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj